

E

BIBLIOTEKA

SHKËRIT

SH-1

566

GJIROKASTER

VEHBI  
SKËNDERI

Kumbojnë  
vitet

POEZI

8JH-1  

---

566

**VEHBI  
SKËNDERI**

**KUMBOJNË  
VITET**

**poezi**

**SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»**

## NË KËTË TOKË

fragment

Në këtë tokë,  
ku kam me dhjetëra vjet që eci mes rrugëve të  
shkelura dhe vragave të ngrira,  
dhe hapi im s'është kompas, që të sajosh një  
rreth, po matës hapësirash,  
ku pika e ujit lëshon dritë dhe nuk ka gur që  
të mos ndrijë,

ku s'di sa qytete të rinj janë vërsnikë me time  
bijë,  
ku s'i mendojmë depo bombash Hënën dhe Yllin  
e Mëngjesit.  
ku çdo thesar të këtij dheu e ka çdokush dhe tërë  
njerëzit,  
ku që nga një tarracë e Jonit vëren pinguinët  
në Artik,  
një baldazor mbi Kil' e vrenjtur, edhe një flu-  
turim kozmik.

Në këtë tokë,  
ku shkojnë çdo mëngjes në shkollë vogëlushët  
tërë gaz e zhurmë,  
(dhe gazin e tyre fëmijnor s'e nxënë sheshet  
edhe rrugët),  
ku ngazëllem si një fëmijë, edhe i shoqëroj  
përdore,  
ku gjithë ata që do të vijnë (stërnipët e  
stërmbesat) do të cicërojnë  
në gjuhën arbërore,  
dhe do të bien dhe do të ngrihen, duke gajasur e  
duke qarë,  
dhe do të hedhin nëpër oborr të stërmundimshmin  
çap të parë!

Në këtë tokë,  
ku vesa ndan ixhi luadheve, korijeve plot degë  
e fletë,  
ku sa kish dheu etje për shi, digjej zemra për të  
drejtën,  
ku nëna ime mbillte misrin pas gjurmëve nëpër  
çdo brazdë,  
ku kam takuar në çdo shteg urinë e sytë e saj  
të xhamtë,  
ku malarikët verdhacukë, mes zhelesh dridheshin  
në trokë.  
ku më ka vrarë gjumin, shpesh, mjerimi, si një  
shpellë e ftohtë,  
ku kam dëgjuar në habi ezanë e gjemën e  
kambanave,  
ku i kam mbajtur mbi kurriz gurët e rëndë të  
muranave.

Në këtë tokë,  
ku shtrojmë ditë për ditë trase dhe ditë për ditë  
mbjellim pemë  
e mund të shkruash dhe me gjak, ti, më të  
bukurën poemë,  
ku shemben gjerdhe, mezhda e mure, edhe në  
hon gremisë klasat

po lufta vlon dhe më e ashpër, se dalin kobrat,  
prapë, nga plasat,  
ku ju vret sytë dritë e diellit gjithë lakuriqve  
të natës,  
ku s'mund të shkelë dot Kizingeri, pëllumbi  
kafe i Nevadës,  
ku s'bjerrim kohën me «debate», reklama e  
gjepura të kota  
dhe s'çajmë kokë për perëndi dhe as për zota e  
super zota,  
ku papa bubuzhel tremb sorrat në plantacione,  
kopshte e vreshta,  
ku dhe i madhi Skënderbe na flet me fjalët më  
të thjeshta.

Në këtë tokë,  
ku mund të rrih nën hijen e një peme dhe të të  
duket pema  
kaq e dashur,  
ku shkon të blesh në treg diçka me njerëzit edhe  
papritur ndihesh i pasur,  
ku përditë bëj dush nën shi e vesë dhe nën  
stërkala balte,

ku era s'bart veç pluhurin e rrugëve, po edhe një  
vështrim të afërt,  
ku s'janë mehur asnjë çast oshëtimat e gjëmimeve  
të hershme,  
ku ecim, çuditërisht, të sigurt sot dhe drejt ditëve  
të nesërme,  
ku dhjetëra vjet kositim driza e ferra dhe prapë  
rrimë me kosor në dorë,  
ku çdo minutë ngremë diçka të madhërishme, por  
s'lypim gradë e varre madhështorë,  
ku lufta vlon dhe në përmasa planetare dhe bren-  
da një qelize,  
ku nuk lëvizin vetëm lumenjtë dhe trenat, por edhe  
malet janë në lëvizje.

Në këtë tokë,  
ku më pëlqejnë ngado shkoj dëbora, dielli edhe  
hija,  
ku thith me tërë mushkëritë ajër nga deti dhe  
korija,  
ku nuk ka gjë që nuk më dhimbset dhe e dua me  
gjithë prushin e zemrës  
demi te pika e mbrame e gjakut dhe në pafundësinë  
e ëndrrës.

## SHKALLËT E BREGDETIT

Shkallë, për të parë brymën në një ledh si tretet,  
tek rrëzën me kazmë poplat poshtë.

Shkallë, për të folur mbrëmjes vonë me detet  
duke mbledhur fiq dhe yj në shoportë.

Shkallë, ku blerimi nuk resht kurrë,  
ku lëshojnë aromë edhe gurët.

Shkallë për të thithur ajër në hapësirë,  
tek na ngre si driza flokët era.

Shkallë, që të shohim veten dhe më mirë;  
shkallë, të notojmë në blerim përherë.



Shkallë, tek kuqjon dhe lulja, dhe fjala,  
shkallë, ku hedh shtat dhe fshati dhe qyteti  
dhe lidh syth e sotnja dhe përralla,  
dhe takohen toka, qielli, deti...

Shkallë, të rrëmbejmë krahët e mëngjesit,  
mos të ngelet kund mendimi struktur.  
Shkallë, mos t'i zerë kurrë ndryshku njerëzit,  
shkallë, që të ngjitesh ti, rini e bukur!

## TURNET

Po marrim ca thërrime ngrice nëpër çizme,  
diçka nga ky acar që rrjep fytyrën,  
një guaskë akull mbi peliçe  
dhe po ju lëmë në dorëzim  
detyrën.

E çfarë po ju lëmë vallë, shokë, tjetër?

Një lëmë-prush  
e dru — ç'na kanë mbetur.

E po marrim prej jush,  
të drejtën për të ngrënë darkë,  
të drejtën për të fjetur.

Po marrim ca thërrime ngrice nëpër çizme,  
dhe po ju lëmë në dorëzim:  
këtë mesnatë.

Një metër borë në sektor — dhe borë bie prapë...

Rreth dy dekada, turnet pa u shkrehur  
Vaut të Dejës, Fierzës, dimrave të rreptë.  
Shokë, mos u habitni në ardhsha pa pandehur  
në Koman, pas mesnate, në turnin e tretë.

## POEZI PËR NJË AVARI ELEKTRIKE

*Shokëve të mi elektrikistë në  
Fierzë e në Koman.*

Heshtin  
pesëdhjetë elektropompat.  
Ujërat. Qindra metra kub çdo çast.

Ç'mund të sjellin në kantier sekondat?

Lumi fryhet, hidhet gjer në mal.  
Kush i thotë detit të egër: ndal!

Derdhen minatorë e sondistë,  
mekanikë, saldatorë, elektrikistë:  
futen, gjer në brez, në baltë,  
duke shembur murin e zi të natës.

Shttrinë kabilot gërxheve e kaçubeve,  
mes gjëmimesh, si dikur, mes plumbave.

Turren nëpër terr, drejt grendave,  
kacavaren shtyllave mes rrufeve,  
pa dëgjuar qyqet e legjendave.

Ngasin buzëhoneve e shpellave  
duke lidhur dhjetëra fije të këputura,  
mes rrufeve, si mes sharapnelëve.

Dhe sikur sprapsohen erërat nga malet,  
dhe tulaten, nën re, rrufetë,  
dhe klepitin me gëzim qerpikët fare:  
dhe diçka i thonë, duke qeshur, Drinit-det!

Dhe kënaqen minatorët e sondistët,  
dhe e ndezin një cigar me qejf elektrikistët...

Dhe pas s'di sa vitesh, rrimë prapë tok, në tavolinë  
shkruajmë bashkë; me kalemin e rrufeve, poezinë.

## SHPEJT

Në detin e Fierzës  
shohin vetveten bjeshkët e Alpeve  
dhe papritur ndihen më të larta.

Pishat përkunden mes erës,  
dhe pyesin të habitura:  
— Motra, nga na keni zbritur?!

Hëna, lidhur gushës një shami reje të bardhë  
si tropojane e bukur,  
flet buzëgaz, duke u parë:  
— E ç'është kjo pasqyrë e mrekullueshme?!

Punëtorët e inxhinierët e vjetër,  
teksa po shihen në kristalet e detit  
prekin ndonjë dregëz  
apo ndonjë thinjë tjetër  
dhe flasin pa zë:

— Mos po thinjemi edhe pak?  
Dhe ndërkaq nisen prapë,  
në kantierin e Komanit.

## VËRTET KJO ËSHTË NDARJE

O nënë, s'po më ndien?

Çukit, këtu, mbi varr me gishta, si me shatë,  
qëroj një fije gram, shkërmoq një plis...  
Edhe më ngjan sikur me ty, po bashkë,  
postatin përsëri në ara nis.

Prashit... e mbjell diku një grusht me farë  
siç mbillnim dikur bashkë me parmendë.  
Dhe s'më besohet dot, që s'të kam pranë,  
dhe s'më besohet dot, që na ke lënë!



Më ke përcjellë rrugëve gjithnjë  
në çdo bëtëjë ti me mua tok.  
Nënë! Të flas me gjithë shpirt, kështu, pa zë:  
më kishe bir, vëlla... po edhe shok.

O nënë, nuk më ndien?  
Kam ardhur, si gjithnjë, këtu tek ti,  
shkërmoq një popël dhe bëj tëharrje  
dhe bisedoj me ty, dhe pyes me habi:  
— Vërtet, ky është varr? Vërtet, kjo është ndarje?

Si shkuan pesë vjet?... Kaq vite s'janë pak.  
E ditët ecin shpejt me vrap të egër.  
E ikën ti nga ne, gjithnjë më larg...  
E qasemi sërish, gjithnjë më tepër.

## MBRËMË

Mbrëmë,  
desh kapa një xixëllonjë.  
E shtriva dorën dhe e tërhoqa.

Mbrëmë,  
u turra pas xixëllonjave,  
edhe për pak kometat desh shkërrmoqa.

Mbrëmë,  
vrapova pas xixëllonjave mes grunoreve...  
Desh kapa dritat e traktorëve.

Mbrëmë,  
m'u dukën xixëllonjat si copëza lirike,  
motra me luleshtrydhet e xixat elektrike.

Mbrëmë,  
tek ndiqja xixëllonjat, gjer në Lenie u ngjita.  
Desha të kap të bukurat, desh kapa galaktikat!

## STATUJA

Na erdhën partizanët natën vonë,  
shkundën dëborën, shpejt, te dera,  
teksa i ndiqte pas si gjarpër era.

Ju mbushëm fët, oxhakun me kërqe  
e pasi hëngrën drekë e darkë, bashkë,  
i zuri gjumi menjëherë.

Bobo! Plot pesë ditë e pesë net pa gjumë.

Atëherë, një partizan, nëna dhe unë,  
dolëm përjashta rojë.  
Na zgjoni pas një ore, kishin thënë,  
që t'ju ndërrojmë.

Rojë...

Hëna e malet na vështrojnë.

Acar.

Grimca të argjëndta mbi vetulla e mbi qerpikë,  
hëna e ngrirë, si copë akull.

Nëna lë vizatime gishtash mbi dëborë.

Zbathur!

Hëna rrëshqet në qiell...

— Po shkoj t'i zgjoj, — na thotë nëna.

Por kthehet shpejt, pas tre minutash, si e zënë në  
faj:

— E di... ata po flimin posi shqerra.

I zgjoj më mirë pastaj.

— Ashtu vërtet, — tha partizani. —

Ka pesë ditë e pesë net që s'kemi bërë gjumë.

Pas mureve e pemëve e shkurreve mjaullin era,  
na varen copëra gozhdësh mbi qerpikë,  
këmbët na shpojnë dhe na djegin,  
hejet e akujve si thikë.

— Shko bjerë fli ti, bir! — i thotë nëna partizanit.  
Ai i bindet si fëmijë.  
E ngelim rojë ne të dy.

Era leh, mjaullin si mijëra mace, dhelpa e ku-  
nadhe.

Hëna hedh pluhur si flori  
mbi ne të dy, mbi shkrepë e mbi mullare.

Këmbët na janë bërë si prej hekuri.

Hëna edhe bukuroshe dhe kokë prej të vdekuri...  
U bënë s'di sa orë rojë.  
Unë kërcej, që mos më ngjiten shuajt në tokë.

— Po shkoj t'f zgjoj; — flët prapë nëna.

Por kthehet shpejt, pas tre minutash, si e zënë në  
faj.

— I hodha zjarrit ca kërçe.  
E di? Nuk dija kë të zgjoja unë e mjera.  
I zgjoj më mirë pastaj...

Qan, qesh e ulërin si lukuni ujkonjash era.  
Yjet posi thëngjij të akullt në qiell.  
— Shko fli edhe ti, o bir!

I bindem, në sekondë urdhrit të saj.  
Kush ka fuqi të kundërshtojë nënën?  
Dhe ndiej tek pëshpërit: «I zgjoj pastaj»...

Hëna dhe bukuroshe dhe e ftohtë;  
vërtitet nëpër qiell  
e ngjan sikur ndrit kot në botë.

Fryn pa pushim acar dhe erë.  
Hëna ngjan sikur pret çastin që të bjerë.  
Nëna bën rojë...

Akull, kallkan! Mëngjes përmbi Lenie e Bode.  
S'lëviz nëpër përrenj asnjë thërrime ujë.  
Nëna bën rojë...  
Por partizani tek vjen që ta ndërrojë nuk e njeh:  
— Rojë është, nënë... apo statujë.

## ELEGJI PËR BABË REXHËN

Ja tek vjen Babë Rexha, ja tek vjen!  
Çap më çap, pas Babës, treqind djem.  
Malit Skënderbe sërish i ngjitet,  
as e presin shpatat as nga plumbat vritet.

Turru, bre Babë Rexhë!  
Pas çdo guri gjarpëri bufatet.  
Pas çdo ferre ujku i zi tulatet.

Flet një fjalë e dyzet herë matet.

Këmbëkryq nëpër çdo kullë shtrohet,  
flet një fjalë e katër herë mendohet:  
— Rrojmë keq, po bukur do të jetohet!

Fol, bre Babë Rexhë!

Gdhihet bri kapuleve të cigareve.

— Pse s'ke gjumë, o Babë?

— Dua t'u pres krahët gjithë hakmarrjeve.  
Mos gufojë driza e ferra arave,  
të mos fiket kurrë prushi i vatrave,  
të mos i thajë nuset guri i varreve.

Babë, bre Babë Rexhë,  
o bilbil, Babë Rexhë!



As nga Bazi, as nga Gjoni s'tutesh.  
As në kishë e as në teqe s'lutesh.

Çapesh shpejt, po kurrë ti nuk ngutesh,  
në çdo zemër si një zog ti futesh.

Komunist, Babë Rexhë!

Flet për sot, edhe mendon për nesër.  
Flet për dje dhe vëren përtej, pasnesër:  
«Ngordhçi krejt tyxharë, hoxhë e mblesër!»  
Zemra e bardhë të kuqilon, si teser.

Zemra, bre Babë Rexhë!

Ty të mbeti pa u çarë krejt ara,  
por s'të ngeli pa u mbjellë fara:  
— Djemtë e babës, çani ju përpara!

Babë, bre Babë Rexhë!  
Ç'thua, o Babë Rexhë?

Ty ta preu përgjysmë fjalën plumbi,  
krisma e shkretë vreshta e pemë shkundi.  
Porse fjala, o Babë, nuk të humbi.

Babë, bre Babë Rexhë!  
Mos bre, Babë Rexhë!

Ç'u rrëqethën në cingërimë gjethet,  
seç u drodhën dushqe e pemë nga ethet,  
seç u shtangën nga bataret gratë,  
gurët dysh u çanë nga kjo mandatë.

O më i mini i trimave,  
zjarr i vetëtimave.  
O më i urti i burrave,  
uji i kthjellët i gurrave.

Babë, bre Babë Rexhë!  
Komunist, Babë Rexhë!

## HIBE PALIKUQI

Ç'po thërras me mall nga larg kujtimet,  
ato këngë, zjarret e marshimet,  
ato varre ngelur breg më breg,  
por s'u mbledhkan zogjtë në një degë!

Hibe moj, e bukura dibrane,  
me sapun ti dhe dërrasat laje.

Prije vallen, por dhe sulmin prijë,  
halle kish, po ti për halle s'flisje;

vdekje kish, po ti s'besoje vdekje,  
kokëlargatë shkoje në përpjekje.

Cucë dibre, çifteli prej panje,  
me sapun të gurtat shkallë i laje.

Dimër kish, po dimrin s'e përfillje,  
lulëkuqe në dëborë mbillje.  
Toka zhur, po ti si tufë lulesh  
nga muranat mbi transhera sullesh.

Dhe në luftë ti dhe tanket mbaje,  
Hibe moj, e mira partizane!

## PËR NJË BASHKËFSHATAR

Dalin shpesh të vdekurit nga hija  
dhe na ulen prapë në kanape.  
Kush derdh lot sërish nga dashuria,  
kush hedh sytë me qortim nga ne.

E më shfaqesh ti, o shok, në derë,  
mban në dorë prapë një rrënjë ftua.  
Më shikon edhe më thua prerë:  
«Pse nuk thur një këngë dhe për mua?»

Unë zihem papandehur ngushtë  
dhe qortimi yt më ther në zemër!  
Kaq më flet e tretësh posi shkumë,  
kaq më flet e zhdukësh posi ëndërr.

Po më lë dy duar plot gdhenj  
e kaminën dëngëz me dushqere,  
rrokulliset një ortek shkëmbinj,  
tymëzon një furrë me gëlqere.

Që të zbardhë fshati posi dritë,  
ti tre net i gdhin pas një kamine.  
Pikë gjumi nuk vë mbi qerpikë,  
bukë e gjizë, pak raki dëllinje.

Dhe çaktis ti shpesh në urorë,  
tërë gryka bie erë eshkë.  
Pastaj shkund opingat me dëborë,  
shpuz e akull më shkërmoq në vjershë!

## PRANVERA

E zgjati kokën plepi,  
i qiti veshët pjergulla  
i nxoni puplat shtogu.

E kush po fluturon  
më përpara:  
plepi, hardhia apo zogu?

Çeli petalen lulja,  
e ngriti krifën bari,  
mbushi kurorën ferra.

E kush po fluturon  
më përpara:  
pylli, ëndrra apo era?

E shpoi parcelën gruri,  
e hodhi çapin foshnja,  
i hapi krahët flutura.

E kush po fluturon më përpara:  
kalliri, bleta  
apo e bukura?



## I VJETËR JE TI, DRIN

Buron nga Mal' i Thatë,  
ku rronin gjyshërit tanë, enkelejtë.  
Buron nga dherat e begata të Kosovës.  
Lëvizin tok me rrjedhën tënde:  
korijet, malet, qiejt  
dhe kreshtat flokëthinjura të kohës.

I vjetër je ti, Drin, aq sa kjo botë.  
Ç'ka thënë rrjedha jote  
dhe ç'do të thotë?

## SHprehje

Vrapon ti, pa u ndalur, përjetësisht,  
pareshtur,  
qysh kur filloi mbi dhé e jetës ngjizje.  
Gjithmonë i nxituar,  
gjithmonë sypafjetur,  
gjithmonë në marshim  
e në lëvizje.

I vjetër je ti, Drin, aq sa kjo botë.  
Ç'ka thënë rrjedha jote  
dhe ç'do të thotë?

## KAPËRCIMI I KONTRADIKTËS

Kur u ndez në kullë llamba elektrike,  
malësorët panë sa të zes që ishin trarët  
dhe menduan menjëherë për tavanët.

Kur u ndez në kullë llamba elektrike,  
malësorët panë sa shëmti që kishin muret  
dhe menduan menjëherë për gëlqeren.

Kur u ndez në kullë llamba elektrike:  
— Heu, ç'po ndodh, — vikati kulla, — o njerëz! —  
Shih rrufetë! e tmerrshme, demonike,  
fik e i ndez dhe gjyshja me një çelës!

Kur u ndez në kullë llamba elektrike,  
ngjau një hop i bukur dhe tronditës.  
Fshati ndjeu se llamba diç po fliste  
dhe mendoi për shpejtësinë e dritës...

## TI QË KORR PA MBJELLË FARË

Ish bazhdar që s'kishte shok,  
zigjaste grurë dhe urof,  
dhe një pyll dhe një fill flok.

Zigjaste elb e zigjaste bar,  
zigjaste plumb e zigjaste ar,  
zigjaste lypës dhe tyxhar,  
kurrë s'hante në kandar!

Zigjaste deshë dhe deve,  
gjalpë, kripë dhe kafë, —  
mjaltë, mish e qerestë,  
ç'ka në det e ç'ka mbi dhe!

Por një ditë i bujti në prag  
një udhëtar, as djalë, as plak  
dhe si sjell bisedën qark,

hedh lumenj e çan një det,  
nëntë male ngjith e zbret  
e shikon në sy dhe i flet:

— O i mençur mjekërbardhë,  
ti, që zigjat me një të parë,  
ti që korr pa mbjellë farë  
ti që qesh kur duhet qarë:  
veten pisk kur e ke parë? —

Plaku sytë larg i tret,  
ngulur në një pikë i qep,  
do të flasë e mezi flet:

— Unë veten e kam ndier  
ngusht, më keq se asnjëherë,  
kur prej meje njerëzit deshën  
në kandar të zigjas vetveten.

## BETEJA KISHTE RESHTUR

*Shokëve partizanë, që ranë në tetorin  
e 1943-së, në luftën e Peshkopisë.*

Beteja kishte reshtur rreth dy-tri orë më parë,  
po mblidhmim në lëndinë dhe në gëmushë të vrarët.  
Tani, po ai partizan që kishte marrë plagë më shumë  
qe mbështetur të flinte, për të gjitha netët e  
pagjumë!

Na ranë atë ditë dymbëdhjetë,  
e që të gjithë djem, pa nisur mirë jetën.  
E që të gjithë...

Jo, s'ka fare rëndësi, nëse ata që kishin rënë  
nuk kishin lerë në një vend e s'ishin nga një mënë.  
I nxorëm nga një kamp nazist e hynë tok me ne,  
në batalion,  
e menjëherë nisëm këngën bashkë:  
«Kuaq është ku lind e ku perëndon»...

Dhe ja të tërë, sot, nën një flamur, për një qëllim  
u vranë:  
shtatë shqiptarë, një malazes, një grek, tre italianë.  
Njëri Skënder, një Milodin, një Aldo edhe tjetri  
Metë,  
Komunës krejt ia falën gjakun dhe vetëm emrin  
mban  
çdo kush për vete.

Dhe po t'u ndodheshin nënat afër, në katër gjuhë  
do t'i qanin,  
po do t'u vinte zor, prapë, nënave prej njëri-  
tjetrit t'i ndanin.

Dhe po t'u ndodheshin motrat afër, në katër gjuhë  
do të këndonin,



po prapë, me këtë dhe të kuq tok, në një varr do  
t'i mbulonin.

Kërcet ky tehu i kazmës fort, shkrep xixa nëpër  
gurë:

— Shih ç'tokë! — flet dikush nga ne. — Shih  
ç'vend të mbjellësh grurë!

Dheu është i bryllët, tërë vlagë, me ngjyrë si  
qershi.

— Shih, ç'tokë e bukur! — flet një prapë. — Për  
mollë dhe hardhi!

Por ne s'po mbillnim rrush e ftonj në këtë varr-  
-poemë,

po dymbëdhjetë djem heronj, si dymbëdhjetë  
milionë pemë...

Gjakosur rrinë pranë nesh të dymbëdhjetë, shtrirë.  
Presin t'i puthim një nga një, t'u themi lamtumirë!

Kërcasin kazmat me nxitim e nxjerrin xixa-zjarr,  
një varr për dymbëdhjetë, tok, në truallin shqiptar.  
Ushtojnë Drinit bataretë dhe këngët që nuk ndalen,  
dhe qielli përsëri buçet me «Internacionalen».

## KËNGA E KROJEVE NË ZERQAN PËR NAZMI RUSHITIN

Kroje të tejdukshme jemi,  
qeshim si Nazmiu,  
çka nuk dimë ne t'jua themi,  
di ta thotë Veriu.

Nëpër zheg e net të ftohta  
në gjithmënë ecim.  
Dalim thellë që nga toka,  
nëpër mote s'ngecim.

Turremi në çdo lëndinë,  
bleta mbi ne sulet,  
diç na flasin për Nazminë  
fluturat e lulet.

Diç na flasin zaje e kodra,  
diç tregon një valë  
kur e pa e tërë Shkodra  
bashkë me Qemalë...

Nuk ka dheu si ne të kthjellta,  
perla deti i thellë.  
Ja, Nazmiu si ne, o motra,  
shpirtin ka të kthjellët.

Kroje, pa pushim ne rrjedhim  
gjer në det flladitim,  
diç i themi ne dhe detit  
për Nazmi Rushitin.

## URAT E FJALËVE

E di. E ke trupin me plagë,  
kur vrenjtet pak të dhembin e të shpojnë.  
E ke dëshirë të na shohësh bashkë,  
të çmallemi e shokët të kujtojmë...

— Rrini, — na mbledh të gjithëve, tok në tavolinë,  
flet me të rënë njëlloj si me të gjallët.  
Ata (dëshmorët) prapë me ne po rrinë  
dhe tjetër ngjyrë e tingull marrin fjalët.

Biseda çel dritare përmes viteve  
e bëhet fjala rrugë, pyll e gur.

Korabit prapë të dërsur po i ngjitemi,  
po lagin buzën prapë në një pagur...

E fjala skuq si lule në bajame,  
e ngrihet fjala si ballkon mbi kohën.  
Dëborën çan kolona partizane,  
që sa më afër dhe më larg të shohim...

E flakë merr, kur besën shkel ndokush —  
armiku rreh prapë krahët të na marrë.  
Partia mëmë zemrën plot ta mbush,  
por s'të shpëton as vemja pa e parë.

## ÇAST PRANVERE

Çdo gjë më jep gëzim,  
çdo gjë ka tingull, ngjyrë, bukuri,  
çdo gjë më josh:

një zog, një foshnjë, një rrugë, një lule, një  
ëndërr...

Dhe mund të mbush një pyll,  
dhe mund të mbush një det,  
dhe mund të mbush gjithë hapësirat bosh

me këto melodi që kam në zemër.

## NJË TRUMBË BAR

Dielli del mes reeve përmbi Dajt,  
shi dhe diell po kalon ky prill.  
Nga dritarja ime në repart  
vërej përditë një trumbë bar jeshil.

E shikoj tek ndrit tërë blerim  
e freskinë e tij e ndiej edhe vetë.  
Eh, sikur të ketë dhe vargu im  
lëngun që më ka ky bar i blertë!

## PASTAJ SI NJË FAZAN...

Hëna në horizont, mbi të një re si velë.  
Ajo me pash mat tokën, unë me pash mat qiellin.

Ku zhduket tek një mal, ku zhytet në një det,  
pastaj si rosë e artë nga reja gjoksin qet.

Ku fle në një mullar, ku çlodhet në një pyll,  
pastaj tërë gëzim përgjysmë syrin mbyll.

Pastaj si një fazan zbret në ballkon e rri  
edhe me ty gjer vonë flet prapë për dashuri...



## PO, MIRUPAFSHIM!

Po, mirupafshim, det, gjithmonë!  
Më presin tjetërkund sonte për darkë.  
Sirena e trenit nisjen lajmëron,  
buçima jote më përcjell gjer larg.

Dhe kokën kthej të të shoh prapë ty.  
Por nuk të shoh dhe hesht...  
Jo ti, i dashur, prapë me mua flet,  
me mua në vagon dhe ti, o det.

Dhe më kupton, pa folur, çdo mendim  
dhe si manar më bindesh, deti im,  
dhe vjen me mua tok, nëpër shtegtime...  
Dhe dallgën shtron, sërish, në këngën time.

## THËNGJIJ TË KUQ

IMIRIZIA, 1971

*Kovaçit të të gjitha hidrocentraleve  
Heroit të Punës Socialiste, Haziz Vorfit*

Në kovaçanë hyj e dal gjithnjë,  
duart ustait po si qymyr i nxijnë.  
Herë tymos ndonjë cigar me të,  
herë trazoj thëngjijtë në kaminë.

Është e vërtetë, ti ke hak, Kulluc,<sup>1)</sup>  
ka gojë e flet, ka gjuhë prushi i kuq.

Vë mbi kaminë ustai dy-tre qysqi  
e skuqen hekurat, dalëngadalë, si plitka.  
Çekani rreh metalin me furi,  
lëvrijnë xixat si mikrogalaktika.

---

1) Kështu e thërresin minatorët kovaçin.

Ustai nuk flet. Ç'mendon kështu, Kulluc?  
Qymyri nxin, thëngjilli qesh... i kuq.

Si zogj cicërojnë tingujt metalikë,  
mbi gjysmëshekulli shoqërojnë ustanë.  
Dhe s'iu mërzi kovaçit kjo muzikë,  
ky hi, kjo blözë dhe kjo kovaçhanë.

Më flet buzëgaz i rreshkuri Kulluc:  
«Shkruaj një këngë për hekurin e kuq».

I rrjedh fytyrës djersa pors i hurdhë  
e shiu i nxehtë ballin po ia lag.  
Po prapë ustai rreh hekurin mbi kudhër,  
i hekurt ngjan edhe kovaçi plak.

Qëlllo mbi farkë, hej, Kulluc, Kulluc!  
I duhet shekullit, ky thëngjill i kuq.

## VALLJA E FUNDIT

Farefis e shokë plot,  
molla poshtë nuk bie dot.  
Dasmë paçim për nga mot:  
bukë, këngë dhe barot!

Gjyshi Sefe del në valle,  
tund shaminë sikur tallet,  
si djalosh që s'i njeh hallet.

«O ti det që shtyn pamporë,  
hënëz moj, që ndrit oborrë,  
po të pres si top në dorë...»

Vallja nis ngadalë  
si lumë ujëpakë,  
nipçja hyn në valle  
si një bredh i gjatë.  
Bobo! Gjyshi Sefe  
si barut merr, flakë,  
si kaproll i egër  
tre pash hidhet lart,  
i bie takia,  
koka cik tavanë:  
«Iso mbani, shokë,  
nipçe, mbamë, mbamë!...»

Vallja e lehtë posi pendë,  
vallja si një mokër e rëndë,  
shushurin si fletë e gjethes  
nget si kuajt nëpër lëmë.

«As më jep gjilpërën nënë,  
nënë të andronem

se më erdhi dita, nënë,  
kërbë të martonem»...

He-heee, iso mbajnë gjithë dhe vallja nuk mehet,  
tund shaminë gjyshi dhe më keq rrëmbehet  
këng' e tij e flaktë gjër në hiënë ndjehet.

Hidhet lart dy pashë, koka cik tavanë:  
«Iso mbani, shokë,  
nipçe, rrufjan, mbamë!»

Dhe fshi ballin prapë dhe prap' bëhet erë  
dhe nga xhepi i zemrës këngën e re nxjerr  
një të tillë këngë Lenia s'ka ndër:

Diell i madh, o i bukur yll,  
që as fle as sy nuk mbyll,  
po të ul këtu në digë,  
të na mbushësh odat dritë,  
të na bësh dhe shkurref drithë!

Sytë hedh nga qielli, takie mënjanë  
hidhet prap' si vala, koka cik tavanë:

«Iso mbani, djëma, mbamë, niçe, mbamë!»

Lahet gjyshi Sefe, nën një shi me djersë:  
kënga dhe lufta nuk lihen në mes!

Tundet gjyshi Sefe, takiemëjanë,  
kërcen si dragua, koka shkund tavanë:

«Mbani trima, iso niçe, dhëndër, mbamë!...»

«Dasma edhe lufta nuk priten në mes»!  
Duke hedhur valle plaku Sefe vdes.

## EKZEKUTIMI I GJENERALIT, KOMANDANT I SAVAKUT

Të nxjerrim pa ceremoni nga një kamion  
(nuk po të flas me emër, se më nxin vjershën  
emri yt).

Ti na shikon dhe hesht si murg:  
pa tituj, pa pushtet e pa spaleta.

Këtu! Të themi ne.

Ti vëren diku me sytë posi xham,  
në fakt nuk vëren asgjë. Jo, vëren skuadrën tonë  
të hakmarrësve.

Po unë çfarë nuk shoh në ata sy ekran?

— Këtu! — gjëmoj.



Ti i ke kthyer qipariset në trekëmbështa për të  
varur trimat.

Ti ke këmbyer trëndafilat persianë me çdo  
monedhë.

Ti ke mbjellë gurëvarresh në çdo vatër e në çdo  
trevë.

Ti ke shkelur përmbi lule, këngë e rubaira.

Ti ke dashur që t'i japësh kohës damkën tënde  
të pështirë.

Ti u ke vënë vajzave gjerdanë, prangat tërë  
ndryshqe,

ti ke lënë mijëra nëna e mijëra nuse qyqe.

Ti që strukesh posi pulë, para grykës së  
mashinkave tona,

je quajtur «tigër i Bengalit», «xhebrail» e «farë  
e keqe»,

«gjakatar», «mongol», «xhahil» — me një mijë  
nofka të tmerrshme.

Dhe s'ke bërë temena as përpara shahut.

Dhe s'ke çarë kokë për kërrkënd.

Ti, që lutesh të të falim jetën duke na puthur  
këmbët!

— Fol, gjeneral, ç'do të thuash!

— Zot i madh, mëshirë...

Dhe nuk i qep sytë në qiell, po tek ne,  
por pa mbaruar mirë lutjen, të qëllojmë gjithë  
tok, në kokë.

Dhe shikojmë si gremisesh ti, përdhe, nën këmbët  
tona.

Dhe kënaqemi!

Dhe gëzohemi që të gjithë bashkë...

Veç kujdes fishekët, shokë!

Ruajini mashinkat e barutin më së miri  
se ka ndodhur edhe sot, edhe moteve të hershme  
mund të ngjallet pas propozjes prapë «vampiri»,  
më i ndyrë, më gjaksor e më i tmerrshëm!

Po mashinkat mbùshur gati, shokë!

## NANË BIA

**Bie Vokshit**

Një rrugicë e ngushtë, shkurre, baltë e kuqe.  
Një shtëpi tiranase; nëpër qoshik hardhia plot me  
burrë, këmbë gjatë, shpatë drutë, sharrush,

nanë Bia ujë mbush në pus,  
Mbledh një shportë fiq për djemtë, çan me  
spatë drutë vetë,  
del në treg me torbë të psonisë: lakra, qeoka,  
dhe përfund: fishkë • bomba dore. grosh qorre

Dhe në zemër mbart mandatën e Asimit, ardhur  
nga lumi Ebro.

Nanë Bia ecën rrugës shpesh me ngut.  
Lidh një fill që plumbi prapë diku këput.

Nanë Bia di nga vjen e di ku vete:  
torbën mbush me shkronja, plumba e topa letre  
(pa ani se barrë e randë e gërmuq),  
torbën mbush me triko, bomba e yj të kuq.

Po prapë ngutet: s'e ndalon as ngrica, as vapa,  
shpesh me torbën, tok me yjet, nanë e ngratë,  
sjell mandata.  
Kërruset sonte plot mundim... mbart mbi sup një  
kreshtë mali.

Ndalet...

Qysh t'u thotë djemve sonte: «Mbahi, bij, u vra  
Qemali!»

Nanë Bia ecën rrugës shpesh me ngut...

Qep, gatuan, lan e fshia dhe diç mendon.  
Dhe vërtitet posi flutur në shtëpi...

Dhe bën sogje me nagantë, gjumi natën nuk e zë.  
Me të gjallë e me të vdekur, shpesh, nis kuvendon  
pa zë:

Mixha Sulë, trim i lokes, iku pa iu mbyllur  
dhe kur pa se do të ndahej, amanet, tha, ju lë  
plagët  
armët.

Dhe u ngritëm prapë në këmbë,  
prapë na dogjën dhe një herë  
Lamë fushave të luftës nga tri varre për çdo  
derë.

Isha çikë...

Prapë u ndeshëm! Prapë na dogji krali zhurë!  
Lamë roje në çdo kodër, nga tri varre për çdo  
kullë.

Ikëm muhaxhir në borë, përmes Alpeve të larta  
lamë prapa peng shtëpinë... dhe xhandarët krushq  
në vatra!

Nënë Bia ecën rrugës shpesh me ngut.

E troket nëpër çdo zemër, në çdo kullë dhe  
përdhese.  
E tek hyn ndriçon konaku, sikur bart duaj  
rreze...

Po, kur tundet nga bataret, tejpertej, sërish  
Tirana  
prapë mbush torbën me fishekë dhe drejt  
krismës turret nana:  
hedhur një peshqir në kokë, mbathur një  
gjysmëkëpuce  
shkon edhe lufton me Vojon, ja, aty te Kodra e  
Kuqe.  
Shkreh nagantin pa u tutur, edhe pesëfish merr  
hakun:  
për Qemalin, për Asimin, Zojën dhe Emin  
Durakun.  
Dhe mes tymit e gjëmimit, teksa korr rrebeshi i  
plumbte,  
nëna prapë e çan. rrethimin, që të nisët prapë në  
luftë.  
Nënë Bia, ecën rrugës shpesh me ngut...

Po kur kthehet boll e lodhur, nanë e urtë, prapë  
s'rri shesh:  
«Jam pa shkollë, — u thotë djemve, — shumë  
gjana s'i marr vesh».  
Dhe e drojtur, pak si tinës, diç kërkon me ngulm  
në hartë.  
Pa hutohet e djersitet... e humbet... dhe e gjen  
prapë.  
Pa habitet (pak minuta) e diç pëshpërit me vete,  
pas ca shënjzash, si thneglla, vëren kushedi se sa  
qytete!

Dhe kënaqet nana e trimave, si një nxënëse pesë  
vjeçe.  
Dhe imazhin e botës së saj dhe një meridian s'e  
mat:  
që nga Ebro në Gjakovë... në Tiranë e Stalingrad.

Nanë Bia ecën rrugës shpesh me ngut.

Nanë Bia,  
ti s'ke prehje. Ti me ne në gaz e gjëmë.  
Ti je motër, ti je gjyshe, ti je shoqe, ti je Nënë.

## TEKI KOLANECI

Ngjitesh brinjës në Sopot  
ulesh, nën një man, në Hot,  
qullesh nëpër shi, në Drin,  
dimrin në Moravë gdhin...

Po, papritur, nisesh prapë,  
me një ling ti vjen në fshat.  
Çlodhesh krojeve të tij,  
shtatë sulinjarë pi,



bredh malluar në katund,  
kokën kumbulla të tund  
dhe hap gojën një mullar:

— Shkofsh nga shkofsh, ti je gorar! —

Rri një hop... merr prapë yrysh:  
në «pusi» të pret yt gjysh!  
Nëna fët në shkallë del,  
sa të sheh, si dardhë çel:  
(malli s'bën si bora fir)

— Erdhe prapë të na shohësh, bir? —

Gora flet, mendon për ty,  
mal më mal të ndjek me sy...  
Shpesh të lau e të arnoi,  
një qilim që kish të shtroi,  
tok me ty kafshoren ndau,  
tok me ty dëborën çau,  
tok me ty u vra, u dogj,  
me çdo dallgë u përpoq.

Në kufi prapë kthen në çast,  
kënga vjen me erën pas:

Gur i Kamjes, shkrep e mur,  
katër ditë u dogje zhur:  
Shkëmb Tekiu, ti copë gur!

Shtatë plagë e s'bie përdhe,  
shtatë plagë e tok me ne:  
plagët shokëve ua fsheh...

Në Vermosh e në Mursi  
në çdo piramidë ti.  
Trim, o kapedan, Teki!

Ndal e pjek çdo kufitar,  
pi me djemtë një cigar,  
Vidohovë, hov në zjarr.

Ngjitesh në Pogon e zbret,  
(ngele rrugës kaq vjet)  
hesht dhe duke heshtur flet:  
Bre, si pleksen nyja tok,  
emri gur dhe emri shok,  
emri plis dhe emri plep,

emri syth dhe emri djep,  
emri gjol dhe emri blir,  
emri kufitar dhe bir,  
emri tren dhe emri shat,  
emri pyll dhe emri fshat,  
emri zog dhe emri bisk,  
emri qiell dhe komunist...

Në Butrint, Vermosh e Qarr  
në çdo pash një lapidar,  
pika gjak e trumba bar...

Plaga prapë në gji të ther.  
Hesht. Dhe gjumi nuk të merr.  
Hesht. Me zor dy fjalë nxjerr:

— Nder i madh na ra në short,  
mbrojmë socializmin tok,  
të pafjetur, të pamort...

Hesht.  
Sërish merr malet qark.  
Pret me ditë shtëpia prapë,  
pret një telefon, që larg...

Gdhend e gdhend, kam kaq vjet,  
zor të gdhendësh një portret.

## S'PO MBYLLIM SONTE SY

S'po mbyllim sonte sy, as natën vonë.  
Pinë cigare e presim të gdhiet.  
U mbushën pesë vjet... Po nesër shkojmë  
dhe s'flemë dot. Edhe kurrkund s'na irihet.

Ç'po ndodh kështu me ne?  
E pse përzihen tok (në këtë natë) ditë, muaj, vite?  
E ç'do të lëmë ne këtu?  
E ç'do të marrim pas me vete?

Ata shkëmbinj që gjetëm. Dhë më tutje ferra.  
Ca rrugë do të ngelen.  
Ca do t'i gërryesh shiu dhe era...

Ç'po ndodh kështu me ne?  
Të flasim hapur, në fillim, kur erdhëm,  
ndiemë dhe mërzi.

E na u duk ky vend edhe i ngushtë.  
Na priti qielli me batare-shi.

Vështrimet na përplaseshin pas shkëmbinjve.  
Një shoshë qiell mbi kokë kish a s'kish.  
Ne vërenim çfarë s'dukej me bindje,  
tek vinin turn më turn, nëpër ca vraga dhish.

Natyra mund të jetë një mishmash:  
një hon, një ledh, një breg i zhveshur e i plasur.  
Po vjen njeriu, shkel tokën pash më pash  
edhe të bëhet shkrep i kopsht i dashur.

Ç'po ndodh me ne kështu?  
Na pritën gërxhet (kërcënuese) thika-thika  
dhe shpellat, pak të zymta si mistere.  
Po ne e shihnim, si po ngrihej diga:  
mbi dallgët e tërbuara dhe mbi valanga-ere...

Po, nesër ikim prapë..  
Valixhet: rroba, penj, brisqe.  
Një trumbë letra dhe një stilolaps..  
Po Drinin nuk e marrim dot me vete në valixhe.

Një gjysmë buke, djath. Pakon me këmisha,  
një çelës, një pincë, një peliçe.

Po s'mund ta marrim dot Valbonën: ahe e pisha,  
dhe digën, Fierzën, detin... S'mund ta futim sonte  
dot, ne, në valixhe.

Po, nesër ikim prapë...

Diçka mbaroi...

Diçka e re (e papërcaktuar) po lëviz:  
kantiere, zaje, diga, një barakë.

Njëqind beteja i fituam.

Nesër, tjetra nis.

Më e vështira, ndofta, se të njëqinda bashkë.

Po, nesër ikim!

S'po mbyllim sonte sy, as natën vonë.

Pimë cigare e presim që të gdhihet.

U mbushën pesë vjet... Po nesër shkojmë.

As flemë dot! Dhe askurrkund s'na rrihet.

## XIXËLLONJAT

Xixëllonjat

të kujtojnë fosforeshentët që feksin përrenjve e  
pyjeve,

të krijojnë imazhin e meteoritëve dhe yjeve,  
imazhin e lulrave të shëgës dhe të lulekuqit,  
e zilkave të argjendta, që përkundin kecet e bulqit.

Të flasin për pritje dhe takime dashurie,  
ku diçka ka nisur dhe diçka ka ngelur, rastësisht,  
pa u thënë,

të lënë të presësh, nën një bli, në hije,  
të joshin të bredhësh lëndinave në netët pa hënë.

Të bëjnë që të flasësh, si kalama, kot më kot, me  
vete,

të ngutim të harbosh, pa ditur nga vjen e ku vete,  
të shtrojnë në bisedë me vreshtat, me burimet,  
me vitet,

të bëjnë të thërresësh atë që kurrë s'harrohet dhe  
që s'përsëritet.

## S'KAM PARË HËNË MË TË ARTË

S'kam parë hënë më të artë  
dhe natë më të shkurtër.  
Qëndrojmë në lëndinë bashkë,  
përmbi një stol të gurtë.

Cicërojnë mëpër gjethe cinxuj  
e fryn veniu i lehtë,  
përhapin bari e lulet tinguj  
sikur japin koncert.

Derdh hëna kroje në luadhe,  
harbon, si top, ndër qiej.  
Pse më ngjan bota kjaq e madhe,  
kur ndodhem pranë teje?



## MALL

*Kur nuk kisha time bijë pranë.*

Ka ditë që s'ta dëgjoj më zënë,  
i ngjaj një mbremjeje pa hënë.

Nuk di ç'të prish, nuk di ç'të ndreq,  
jam gjol, ku s'vezullojnë peshq.

Nuk di ç'të lidh, nuk di ç'të shkoq,  
jam pyll ku s'cicërijnë zogj.

Ndaj pres të kthehesh përsëri,  
të zbresë hëna mbi çati.

Të di ç'të fshi, të di ç'të ndreq,  
të mbushet gjoli plot me peshq.

Të di ç'të thur, të di ç'të shikoq,  
të mbushet pylli plot me zogj.

Të ulet hëna mbi çati,  
të më mbëshitetësh kokën në pëqi.

Dhe të më cicërosh ngadalë,  
babi, tregomë një përrallë...

## KOKËN TUND ME NJË MENDIM NJË PLEP

Cicëron një zog, diiku në gjeth,  
ligjëron një çift nën një bli.  
Kokën tund me një mendim një plep,  
tund buqetën rozë një qershi.

Mbledh nektarin bleta varg në varg,  
fryn veriu aroma që s'i njoh.  
Unë flas me lozonjarin fllad,  
unë flas me yjet që s'i shoh.

Kruan dhëmbin një kërthi në bar,  
lisi i butë përsëri u vesh,

një traktor gjëmon nëpër ugar,  
një glob hëne më shikon e qesh.

Një mëllenjë në një shelg çukit,  
mbrëmje e bukur dashurinë ndjell.  
Unë e ndiej burimin ç'pëshpërit,  
unë e di e nesërmja ç'po sjell.

Lule prapë në vargje po shkërmoq,  
vargjet zhyt si rosat në liqen.  
Unë flas me peshq edhe me zogj,  
unë flas me shëkullin që vjen.

## KAM MALL

Kam mall

për një ditë të zakonshme pak të vrenjtur,  
ku të tund si shelg marrokja erë,  
për një rrugë që lëviz pareshtur  
e lëshon pareshtur tym të verdhë,

për një këngë çiftelie,  
që sjell në barakë buzë mibrëmjeve  
gurrat e Gjalicës e Lenies,  
erën e çerepit dhe lëmenjve...

Kam mall

për ata që i lexojnë letrat e të afërmve  
pragjeve të digave dhe uzinave  
e ju shkruajnë fëmijëve që majë skelave,  
dhe i ndejnë shpesh këmishët ferrave,  
dhe arnohen në një fron pas porit,  
dhe mallohen për gishtërinjtë e nuseve...

Kam mall

për një muaj sulmi në kantier,  
ku s'ke nge të hash një copë bukë,  
(skuq për natë tërë horizonti)  
dhe çdokush mban postin, si në luftë,  
dhe çdo gjë merr ngjyrën e një fronti.

## S H I

Shi, ti vreshtin si një nënë e mënd  
e tuk-tuk më nge katit çdo plis.  
Ti këdo thërret sot në kuvend  
dhe me shëlgjet një përrallë nis.

Shi, që më çukit tuk-tuk,  
të shikoj edhe me sy të pi,  
ti më bën dhe muzikant, dhe bujk,  
ti më bën fëmijë dhe bari...

Ti qillim blerimin shtron në shesh  
e ja, prapë, kërpudha këput mbi bar,  
tuk e tuk më guçurit në vesh,  
tuk e tuk me ty lumenjtë marr.

Dhe paçka se rrugët i përbalt  
dhe ndokush të quan «monoton»,  
ti kërcen si kecat mbi asfalt  
dhe në çast drejt reve fluturon.

Ti nën strehë më thërret plot mall  
edhe prapë për cinglën nis më flet...  
Ti je grimcë aq sa je dhe mal,  
ti je pikë aq sa je dhe det.



## NA BËJNË SHOQËRI TRUPAT KOZMIKË

Në oborr na gudulis kjo era e gëlqeres,  
hëna nga pemët shpupuris balulket,  
ti herë buzëqesh e herë vrenjtësh,  
posi një yll që feks një çast e zhdukët.

Pastaj ngre kokën e papandehur thua:

— Ç'thotë për mua hëna?

— Ajo tregon se unë ty të dua,  
nuk them më fort, por jo më pak se nëna.

Vëren në qiell dhe përsëri më thua:

— Ç'thonë për mua yjtë?

— Ata tregojnë se unë ty të dua  
nuk them më fort, por jo më pak se sytë.

Pa qeshim tok me lot në qerpilkë,  
e prapë, papritur biem në mendime.  
Na bëjnë shoqëri trupat kozmike,  
o ti e bukura, tokësorja ime!

## ÇËSHËTJA UOTERGEJ

*(Fjala e një senatori të partisë demokrate amerikane për skandalin e Uotergejt)*

Më vjen të qesh, të sokëllij, të vërshëllej  
për epopenë «Çështja Uotengej».

Tepër të ndershmëit miliarderë demokratë,  
të çiltër, të pafajshëm, delikatë,  
tek bisedonin, ndershmërisht, kokë më kokë në  
kryegjyshatë,  
dësa bandillë, xhenxhefilë, karafilë,  
djaj me zile,  
të veshur pabesisht «hidraulikë»,

dësa palaço me detyra të posaçme,  
i regjistruan fund e krye  
bisedat tona më intime e të pafajshme...

U errën treqind yj e treqind diej  
nga e përbindshmjia «Çështja Uotergej».

Zotërinj,  
komisionerë, gjyqtarë e senatorë,  
besomëni, por që nga ajo orë,  
që u njollos kaq pabesisht demokracia jonë ideale,  
filloj t'i zihet fryma tërë globit,  
të dallgëzohen detet,  
të mjegullohen fusha e male,  
se, që nga Veza e Kristofor Kolombit e këtej  
s'pa historia jonë një batërdis të tillë  
si «Çështja Uotergej»!

Zotërinj,  
kësaj i thonë mos t'i besosh xhakëtës që ke  
veshur,  
mos dish kur duhet qarë, mos dish kur duhet  
qeshur,  
mos dish kush është bufi dhe kush është pëllumbi,  
mos marrësh dot me mend nga të vjen rrezja e  
diellit e nga të vjen plumbi,

mos shquash dot përkëdhelinë nga një dackë,  
mos dish ç'ndryshim ka dasma nga një grackë,  
të presësh nga të afërmit çdo sekondë, pas shpine;  
thikën  
dhe kur t'i flasësh diçka intime gruas të kesh  
frikë..

Besomëni, por që nga fushata e zbutjes së  
lëkurëkuqve e këtej  
s'pa historia jonë përbindësh më të keq,  
se «Çështja Uotergej».

Zotërinj,  
s'gabojnë ata që thonë se Amerika është parajsë,  
ndonëse të varfrit presidentë e kanë kokën në  
trastë;  
tek ne jetojnë miqësisht njerëz, kafshë, peshq e  
shpezë —  
të gjithë kanë shoqëritë, klubet e gazetat e tyre! —  
bile edhe për një kone, zonjusha Mimi mund të  
shpenzojë sa një mbretëreshë  
pa qenë gjak apo fis mbretëror prej natyre.

Dhe CIA e shtyrë nga dëshira dhe nga ndjenja  
tepër të pastra,  
si dhe nga një detyrë tepër sublime:  
ka incizuar miliona biseda telefonike, në miliona  
lastra —

por, mbani vesh, zë be: asnjë bisedë intime!  
Kurse këta bandillë faqezes,  
nuk lanë asnjë të fshehtë midis mesh.

Të ndershëm zotërinj!

Jetojmë në një mot, kur s'di njeriu i varfër  
ç'është turp e ç'është nder,  
kur ngrysesh me një gaz e gdhahesh me një tmerr,  
kur del shëtit në park e ndien se s'ke këpucë  
(t'i kanë vjedhur edhe s'ke ndier)  
kur qielli pambarim të duket si birucë, —  
edhe kur është i kthjellët, edhe kur është sterrë —  
kur shkon t'i rrëfesh zotit, edhe të pret mashinka  
mu në qelë,  
gangsterët filasin shikunt: o kokën, o dollarët!  
Kur miiku dhe vëllai ta hapin varrin më të thellë,  
kur djalli më katran, mban pelerinë të bardhë.

Zotërinj, besomëni, për emrin e të plotfuqishmit  
dhe për qimen e hijit —

por, që nga shekulli i artë i Lincit e këtej —  
kur varnim, digjnim e linçonim me miliona zezakë,  
që t'i civilizonim e t'i bënim sa më demokratë,  
s'pa historia jonë tejpërtej  
një krokodil të tillë kaq të zi,  
si «Çështja Uotergej»!

## SHOKU DIEGO

*Në simpoziumin e të rinjve marksistë-  
-leninistë e revolucionarë të disa vendeve  
të botës, që u zhvillua në Portugali, në  
gushtin e 1978-ës, merrte pjesë edhe një  
veteran i Luftës së Spanjës.*

Të therrin plagët ende,  
të shpojnë dhe të djegin.

Si thua, Diego?

E ku i more, vallë, këto plagë?

Në Barcelonë, në Madrid apo në Ebro?

Plagët e vjetra therin fort në mot të vrenjtur,  
po ty të shpojnë dhe më keq nën qiellin e

kthjellët.

Në dritë, ti vëlla i vëren më afër  
si dergjen të papunët dhe të mjerët.

Po, shoku Diego,  
plagët e vjetra therin keq nga mezi i natës  
po ty të çajnë dhe më shumë në mesditë.  
Në dritë e vëren armikun dy pashë afër  
dhe të vjen plasja kur s'ia nxjerr mëlçitë.

Po, shoku Diego,  
dyzet vjet të torturuar, të burgosën  
e zemrën tejpendej të çanë.  
Po nuk të vranë dot, jo, nuk të vranë!

Trim, shoku Diego!

Ti ke në trup aq cifla gjylesh  
sa janë varret e të gjithë shokëve që t'u vranë,  
po nuk do të ndije as edhe një prej tyre  
sikur ta, shihje ti Komune Spanjën.



## SATELITI

Nga Zvicra në Nju-Jork, Marok e Panama  
kërkon azil gjithkund e kurrkund azil s'ka.

E madhe, thënë, bota: tokë e dete pa kufi,  
posi s'gjen një shpellë kund, eks-shah, të fshihesh ti.  
Harbon posi kangur, një ferrë s'gjen në glob.  
Ku je, Aristofan, dhe ti, i urtë Ezop?

Ku puth si shenjt kuranin, ku si peshkop bën kryq,  
por edhe papë të bëhesh, prapë nuk shpëton pa  
gjq.

Ke zhvatur sa ke mundur. Ke qerre me flori.  
S'blen dot një vrimë miu, të rrosh pa frikë ti!  
Gdhihesh në Marok e ngrysesesh në Panama  
dhe tmerni pas të ndjek, o kobër, o eks-shah!

Ke roje dhe sherifë dhe dedektivë plot  
por nga ndëshkimi i madh në tokë s'të mbron kush  
dot.

Ndaj lutju miikut Xhim — ti asnjë çast mos prit —  
që sa më shpejt, eks-shah, të hüdlesh satelit.  
Dhe nëpër qiellin e madh në mjegullnajat gri  
ndofita po gjen, eks-shah, diku një shpellë ti.

## KËNGË PËR TAKSAT

Taksë, sa del në rrugë!  
Taksë, sa zbret në shkallë!  
Mund ta kuptojë bongjezi, pa taksë, jetën vallë?

Taksë në ashensor!  
Taksë, prurësi i gazetave.  
Taksë, Parkut Mbretëror.  
Taksë, fugisë së plehrave.

Taksë!

Çdo hap që hedh në paradizin kozmopolit.

— Sinjor! Gospodin! Mistër!, Mësjë...

Prit!

Taksën.

Taksë në kilometrin 50-të.

Taksë, nën një bredh, nën një ulla, nën një ulli...

Se lisi qenka pronë e konteshës Elizabetë...

dhe bredhi prona e dreqi vetë e di!

Taksë, tek vëren një panoramë, buzëdetit —  
se deti është pronë e misis Xhaklin.

Taksë, nën diell, midis qytetit  
se është diell i mbretit Zaudin!

Taksë, në pisk të vapës dhe në janar, kur mardh.  
Taksë që bën të ndiesh, kur troket dera, ankth...  
Taksë!  
Taksë, kur pi ujë në një çezmë.

Taksë, kur shkon bën ujët në W.C.  
Taksë, kur rri të çlodhesh nën dritën e hënës  
se e ka blerë hënën miliardieri X!

Taksë, ngado që të ndalosh.  
Taksë, që ta bën më të thatë se një kafkë  
shpirtin!  
Taksë, për senatorin, për gardianin, për priftin!

Taksë! Taksë!

Taksë, në të gjitha rrugët!  
Taksë, në të gjitha gjuhët!

Taksë, që s'taton xhepin po emrin njeri.  
Taksë, që të vret sa njëqind breshëri!

Taksë, kur ble diçka,  
po dhe kur s'ke ç'të blesh apo të shesësh.  
Taksë një mjek, një polic, një tregtar.

Taksë, edhe kur vendos të vdesësh.  
Taksë, për kurorën... për qivurin... për dy pashë  
varr!

Taksë!

Taksë, që të bën të shtrëngosh dhëmbët e të ngresh  
grushtin varë,

Taksë, që të ngre të gjuash me rrufe!

Taksë!

P O E M A

ISA BOLETINI

Çirren korba e laraska,  
lot Evropa cirk me maska, —  
ngrenë leqe e ngrenë gracka.

Ngrenë kurthe e ngrenë prita,  
tundin kama e mprehin thika:  
Ku-ku! — qeshin, — erdhi dita!

Frynë trompa e rrahin lodra,  
rreth kambanat Moska e Londra,  
Franca, Nemeja e qindra kobra.

Shtien kralët që nga shkurret,  
që nga hatujt e hauret,  
gjegjen flakë më flakë koburet:  
— Burra, djem! — Isa turret.

Qitin pushikët e nagantët,  
krisma në Ribnice<sup>1)</sup> hapet,  
si ortek, rënkojnë Alpet:  
— Isa kurrë i gjallë s'kapet! —

---

1) Lumë, në Çetinë.



Ndizet si rrebesh pënpjekja;  
shtatë koka sot ka vdekja,  
shtatë koka e qindra kthetra,  
Isa shtatë djem si shkrepë.

Nxihet vendi nga gazepi,  
dridhet anë e kënd qyteti,  
me gjëmim hap gojën deti:  
— Flisni, male, kush na mbeti? —

Shkrepin xixa — zjarr potkonjtë,  
ndalen gurrat, ndalen krojtë,  
heshtin erërat, heshtin zogjtë:  
— Heu, ky kob memec ç'po thotë?

Vrik Ajlkuna del te dera:  
— Pse ndaloi fluturimin era?  
Isë, ku m'i le djemtë, e mjera?

— Mos u trand, e mira loke!  
Në Jezercë me pishat sogje,  
hije i bëjnë kësaj toke !

Dridhen trarët e shtëpisë,  
thua kulla u vithis,  
thua toka u batis:  
— Nipat ku m'i ke, o Isë?!

— Motër, mos dëgjo çka thonë,  
Kaçanik, thanë, po pushojmë.  
Thanë, vijnë pak më vonë... —

Kuajt të tërbuar mbërrinë,  
s'hanë ellb e ujë s'pinë,  
vajmedet, të flasin s'dinë:  
— Vranë Isa Boletinë!

Isë ,o lis që nuk fle gjumë,  
heu, të dhembin plagët shumë,  
në Cetinë, në atë lumë?

— Shoshë jam nga thikat vetë,  
plumbat keq m'i grinë djemtë.  
Nipat m'i zhuritën flakët,  
skuqin nipat gjak nga plagët.

Po më e thellë se çdo varrë,  
po më e hidhur se çdo gjëmë:  
Shqipëri, ku po të lëmë?

Isë, ç'plagë të dhemb më tepër,  
plagë e re a plagë e vjetër?  
Mos ky plumb që vret në dhpinë,  
Manastir e në Cetinë?

— Heu, s'ka plagë për burrërinë!

Ah, Kosovë o e mira loke,  
lule e kuqe e kësaj toke!

Ca të vrasin, ca të rrjepin  
gojën duan të ta qepin.

Ca të hedhin e të presin,  
në pazar përditë të shesin.

Ca ta fshinë fare emrin,  
sytë duan të 'ti nxjerrin.

Ca të shuajtën troje e fshatra,  
të dëbojnë larg nga vatrat.

Ca të lajnë e të lyejnë,  
njëqind fish më keq të fyejnë.

Ca të shkelin e të djegin,  
gjallë duan të të pjekin.

Por nga hiri prapë mbin bari,  
pas dëborës vjen behari...

— Eh, Kosovë, o nënë loke,  
kurrë, prush' i kësaj tolke:

kokëlar, ti, ndër vjete,  
kurrë pas në sulm nuk mbete,  
në acar e më tërmete  
me një pushkë e me një djepe...

Ti më linde, ti më rrite,  
zemrën sofër ti ma qite.  
Ti në Cernalevë më ngrite,  
ti plot mall, si bir më prite...

Ti në kopsht, si bli më mbolle  
(erë bli dhe lule molle),  
në Kaçanik me mua dole,  
ti në Vlorë më përcolle...

— Isë, o pylli plot çatalle,  
pesëdhjetë vjet me robtë s'u çmalle,  
pesëdhjetë vjet kaçak në male...  
Me armatën në Shkup u ndale!

Isë, kreshnik nëpër lahuta,  
larg prej shilteve të buta,  
nga trumpetat e nga shputa,  
gjeneral të gradoi lufta!

Isë, o gjeneral pa shkollë,  
këmbët me tre gishta shollë:  
drodhe car e kral Nikollë,  
tunde Vjenën e Stambollë!

Shkrepën rrufe e nuk u trembe,  
shkanë bedenë e nuk u shembe,  
shterën gurra e nuk u shtere,  
nxinë mote e nuk u erre,  
shkanë kulla e s'u batise,  
le një sulm e tjetrin nise,  
frynë orteqe e në vend mbete,  
tretinë frone, ti s'u trete.  
Vdiqën krafe, ti jetove,  
ranë tërmete, s'u mbulove,  
ranë male, s'u rrëzove!

## SHOTE GALICA

Mes hapësirës, si kometë,  
del një vajzë me gërshetë,  
ndofta gjashtëmbëdhjetë vjetë.  
Shfaqet për një çast e zhduket,  
prapë diku më e bukur duket.  
Prapë humbet në një korije,  
diku vajzë, diku hije:  
me nagant në pjacë shtie!



Malet ngjit e zbret në fushë,  
ku si gjeth, ku si drenushë,  
diku ëndërr, diku shpresë  
diku nuse, diku shpresë,  
diku lule në qëndismë,  
diku xixë, diku krismë.  
diku yll e diku hënë,  
diku motër, diku nënë.

S'reshitin asnjë çast bataret,  
s'kemi nge të hapim varret,  
të mbulojmë tok të vvarët...

Ngelëm muhaxhirë në rrugë,  
s'kanë kalamajtë bukë,  
s'kanë foshnjat gji të pinë,  
rrugës, nën dëborë gdhinë...

Ka një brengë e ndien një shembje,  
zemra i dhemb nga mijëra dhembje.

Ka një plumb e ka një plagë:  
— Bacë, kur po marrin shpagë? —

Ka një anktë e shumë derte  
(në të parat hapa jete)  
që e ndjek kudo që vete:

— Gospodar, o gjarpër shkurresh,  
ti përditë ndërron lëkurë!

Doni të na shkulin fshatin,  
mos të ngulim kurrkund shatin,  
kllulka zoqat mos të çelin  
mos të korrin,  
mos të mbjellim!

7

Mos të mëndim foshnjat pak,  
mos të qeshim tok në darkë,  
mos të ndjellim gaz në zemër,  
mos të shohim diell as në ëndërr,  
mos të ndiejmë as cul, as lodër,  
mos të bujtin miq në odë,  
mos të veshim dy kut basmë,  
mos të presim krushq në dasmë!

Pse na, vini, pa ju ftuar?  
Pse na shtrohi, pa ju shtruar?  
Pse na digjni, pa ju djegur?  
Pse na rrjepni, pa ju rrjepur?

Pse na lypni borxh, pa dhënë?  
Pse na lypni gjak, pa gjëmë?

Pse na tallni, pa ju cytur?  
Pse na shtyni, pa ju shtytur?  
Pse na shisni, pa ju blerë?  
Pse na themni, pa ju prerë?  
Pse na shani, pa ju sharë?  
Pse na vrisni, pa ju vrarë?

Shotë, nuse si perri,  
s'nusëron. ti në shtëpi.  
S've këna të kuq në thua,  
shtamat ti, s'i mbush në krua,  
brumë nëpër duar s'ngjit,  
pite dhe byrek s'gatit,  
nuk del në oborr me fshesë,  
dhen e dhi nuk mbyll në lesë,  
teshat nuk i njom në lumë,  
llërët nuk i zhyt në shkumë,  
një fustan si nuse s'qep,  
nuk end dot shpërgënj për djep,  
nuk thur ojna e nuk qëndis.  
Heq duvakun e luftën nis!

Shotë, vajzë fjalëpakë,  
zgjodhe lirin më të lartë,  
zgjodhe këngën më të flaktë,  
zgjodhe rrugën më të gjatë.

Zgjodhe pyllin më të thellë,  
zgjodhe lumin më të kthjellët,  
zgjodhe malin  
zgjodhe qiellin!

Zgjodhe trimin më të besës  
dhe gjerdan rrëketë e djersës  
dhe inxhinj pilkat e vesës...

Zgjodhe dimrin më të ftohtë  
zgjedhe erën më të fortë, —  
Dhe të thirrën burrat: Shotë!

Nuse e motër, në një çetë,  
seç të presin bataretë,  
thonë, mirësevjen rrufetë!

Pret me çetën, Shotë, prenë,  
plumbat breshër nuk të zenë,  
emri yt përditë merr dhenë!

Gjak e varr në çdo pëllëmbë,  
s'ka armik që s'merr në shenjë,  
shtie pushkë apo thur këngë?

Arbani, një lëmë qiell,  
gjysmë zjarr e gjysmë shpellë,  
gjysmë hije, gjysmë diell!

Arbani, një bahçe lule,  
kokën kurrë nuk e ule,  
emrin mbi një shkëmb e ngule!

Arbani, ti mal e kodër  
tok gjëmon dhe top dhe lodër,  
dielli qesh në tym, si gogël.

Arbani, shqiponjë detesh,  
seç u ngrite mes tërmetesh,  
shkëmb më je e shkëmb do mbetesh!

Shotë, rrugës ditë e natë  
shkel në zall e shkel në baltë,  
dhe zeher, dhe pite mjaltë...

Ecën nën diell dhe shi,  
hejt e akujve syngji,  
në çdo grykë një pusi.

Pritat çan si era ti!

Ndjellin zi për ty oxhakët,  
bejtexhinjtë dhe bajrakët.

Ty të nëm xhami dhe kishë,  
shenjtë, dreqër dhe dervishë.

Ty të nëmën magjistrica,  
Cari, krali dhe kralica :

— Ti je xhind, ti nuk je çikë,  
vret me plumb e therr me thikë.

— Ti je dreq, ti nuk je vajzë,  
koka njerëzish mban në trajisë.

Pret të lërë dielli tokën,  
t'i shkurtosh xhandarit kokën!

Por ti nuk dëgjon se ç'thonë,  
bredh e fluturon gjithmonë,  
herë zog, herë shqiponjë!

Ti s'pret fatin prapa brave,  
si një lypëse, si një skllave.

S'shkrin në lot pas një ikone,  
S'qesh si kukull në sallone...

S'endesh rrugëve si hije,  
s'rron me profka xhelozie,  
me takime dhe me ndarje...  
Ti mbush pushkën për hakmarrje!

— Gospodar, ju shoftë gjëma,  
vrisni pleq e gra shtatzëna,  
digjni vreshta e shkëlqi grurë,  
zhvatni dhe nuk ngopi kurrë!

Ti nga mumjet s'pret të drejtë,  
ligjet ti i shkruan vetë,  
mal më mal, me plumb të nxehtë!

Ti si lutesh vdekjes: Mos...  
Vdekjen ti e shpon në gjoks!

Shkon mes sulmeve si predhë,  
qesh e tallësh me çdo zgjedhë.

Shqyen çdo kanun teligë:  
mijëvjeçarëve iu bën sfidë!

. . . . .  
Shotë, motër e dashur, Shotë,  
linde ti me këngën tok,  
zogjtë e lisat pate shokë.

Ti u rrite mes kullotave,  
midis këngëve dhe lotëve,  
mes gjëmimeve të moteve...



Ty të vranë dhe të dogjnë  
zemrën çika ta shkërmoqnë  
larg prej vatrave të ndoqnë.

Ti varros, fshehtas, në shpellë  
treqind pash në gropë thellë:  
zemrën dhe një copë diellë.

Heq litarin me ngadalë:  
Pse s'më flet, Azem, një fjalë?  
Mos po më lëndohesh vallë?

Po, Azem, — mendon me vete —  
ç'varr e ç'fat zgjodhe për vete.

Skifter ishe e skifter mbete...

Zgjodhe varr një shkëmb-zgërbonjë,  
hasmi varr mos të shikojë,  
hasmi vaj mos të dëgjojë...

Vjen e qan nëna shqiponjë. —

Çapesh, ti, mbi varre e doke,  
mbi çdo plis të kësaj toke,  
mbi çdo kob të kësaj bote...

Hapi tënd kumbon ndër mote!

Ku shkel ti, oicërom gushkuqi,  
ku shkel ti, skuq lulekuqi,  
ku shkel ti, lulëzon qershia,  
ku shkel ti, bleron korija.

Ku shkel ti, nrjedh kroi i artë,  
ku shkel ti, mbijn pishë e lartë,  
ku shkel ti, tret thatësira,  
ku shkel ti, nis hapësira,  
ku shkel ti, flori shtron hëna,  
ku shkel ti, puth tokën nëna,  
ku shkel ti, shesh shtrohet grenda,  
ku shkel ti, lidh syth legjenda.

Ti je gjeth i blertë në pjergull,  
ti je zogu mbi një tjegull,  
ti je hëna nëpër mjegull,

Ti je lulja majë shkrepit,  
ti je klithma, mes tërmetit  
ti je rrezja midis detit...

Kënga jote shkrep vetëtima,  
ti, në çdo tufan, me trimat!

Fjala jote kthjell si gurra,  
prijëse të zgjedhin burrat.

Vërejnë kullat e mahnitën:  
— Lum si ne se ç'Shota rritim! —

Qeshin krojet, tunden pyjet  
diç tregojnë retë e yjet...

## MANUSH ALIMANI

*Sigurisht, s'e kam të lehtë  
që t'ju nis nga burgu letër.*

Jo se më pengojnë muret  
dhe kapitem mbas torture,  
dhe nuk shoh nga sytë mirë,  
dhe betoni më ka ngrirë —  
si të ketë zënë bryma, —  
dhe çdo çast më zihet fryma,  
dhe më shpon në gjoks, si pykë  
dhe mendimi ngec në grykë.  
Por, ç't'ju them, mendoj me vete,  
ç't'ju lëndoj me copa letre?

Jo se jam për ju i huaj  
dhe përtoj një rresht të shkruaj,  
dhe t'i bëzaj dikujt një fjalë,  
dhe të kap në rrjet një valë,  
dhe të pëshpërit me erën,  
kur nget link tok me pranverën,  
dhe të flas me cyle e saze,  
dhe me sytë e një vajze,  
dhe të qesh me loken Shkodër,  
dhe të rrah për gas një lodër. —

Po ç't'ju nis nga burgu — ajme!  
Helm këtu pikon nga lajmet!

Por dhe te ky varr — lugat,  
diç kam ngelur delikat...

Dhe kërkoi një trap mbi Bunë,  
dhe një gurrë ujëshumë,  
dhe një tendë hardhi mbi portë,  
ku të cicërojnë zogjtë,  
dhe një pishë, si gjirafë,

dhe një mbrëmje në Rozafë,  
që të flas diçka me hënën  
dhe të fluturoj me këngën,  
dhe t'u çoj një lajm të varfërve,  
që më presin, midis hasrave,  
dhe t'u them një llaf të vrarëve  
pemëve të trotuarëve,  
nipave që s'kanë lindur  
dhe tufanit të pabindur. —

Po ç'tju shkruaj nga kjo strofikë?  
Nëpër gjak notoj në trokë.

Sigurisht, zor del një letër  
nga ky katakomb i vjetër:

Jo se m'u fashit kujtesa  
dhe nuk ju kujtoj adresat,  
dhe s'e di që vëreni derën  
(prisni orë e çast konierët),  
dhe s'ndiej shënd të rendim, shokë,  
me një kamotier të grisur,  
nëpër vapë, në Shirokë.  
Dhe s'kam qejf të lexoj prapë  
tërë Gorkin — në një natë,

dhe të gdhijem në debate,  
dhe të çaj në demonstrata,  
si zgalemi mes shtrëngate —  
dhe të më zhuritë flaka,  
dhe të hidhem mbi bastione  
të gremis pallate e frone. —

Por s'më tundin, oh, as shtangat;  
dy-tre tonë peshojnë prangat.

Dita, në një mijë troha,  
me këmbalka çapet koha...

S'ka torturë që nuk njoha.

Nxin racioni sa një komçë.  
S'kam ku gjej të ha një dromçë.  
Mbledhur gjuha si këpujë,  
shtatë ditë pa pirë ujë...

Dhe s'më nxë, tani as vetja  
dhe lëshoj duman nga etja.

Digjem e zhurit, si prushi.  
Prapë s'më lë të vdes hetuesi.  
Me patkonj më shemb xhëndari,  
tundet, si çengel litari

Dhe thëngjij në gjoks më hedhin,  
në korent (për tmerr) më dredhin,  
dhe s'ka plagë që s'më gërryejnë,  
dhe s'ka brinjë që s'më shqyejnë,  
dhe në varr i gjallë kallem,  
dhe çdo orë vdes e ngjallem,

dhe më rrjepin tri lëkurë,  
më zhuritim eshtrat zhurë.  
Unë prapë përgjigjem:  
Kurrë!

Jo! Do të sfidoj çdo gjendje,  
çdo përqeshje, linç e dhembje.

Kryq e ferr të më mallkojë,  
rrufe reja të pilkojë,  
zjarri furrë të më pjekë,  
krejt të më mbulojnë ortekët,  
trupin shqyer copë-copë  
njëqind pashë nënë gropë.



Unë do të hov në këmbë,  
do të shkund çdo kob e gjëmë,  
do të shqep çdo ganxhë e bravë,  
do të shkrij vargonj në llavë,  
burg, borgjezë e gardianë  
do t'i fshij kudo që janë.

Dhe posa të marr pak frymë,  
pa ia hequr diellit synë,

qiellin do ta shtroj si letër,  
penë do të shkul një eshtër,  
fjalë — gjithëçka gjuhë e nënës,  
bojë — gjak të kuq prej zemrës,  
edhe do t'ju lë përjetë,  
(në çdo ditë që zbardh të shkrojtur)  
këtë testament të thjeshtë:

Shokë, jemi të pamposhtur!

## PASQYRË E LËNDËS

	faqe
Në këtë tokë .....	3
Shkallët e bregdetit .....	8
Turnet .....	10
Poezi për një avari elektrike .....	12
Shpejt .....	14
Vërtet kjo është ndarje .....	16
Mbrëmë .....	18
Statuja .....	19
Elegji për Babë Rexhën .....	23
Hibe Palikuqi .....	27
Për një bashkëfshatar .....	29
Pranvera .....	31
I vjetër je ti, Drin .....	33
Kapërcimi i kontradiktës .....	35
Ti që korr pa mbjellë fare .....	37
Beteja kishte reshtur .....	39
Kënga e krojeve në Zerqan për Nazmi Rushitin .....	42

Urat e fjalëve .....	44
Cast pranvere .....	46
Një trumbë bar .....	47
Pastaj si një fazan .....	48
Po, mirupaishim! .....	49
Thëngjij të kuq .....	50
Vallja e tundit .....	52
Ekzekutimi i gjeneralit, komandant i Savakut .....	56
Nanë bia .....	59
Teki Kolaneci .....	64
S'po moyalim sonte sy .....	68
Xixëllonjat .....	71
S'kam parë hënë më të artë .....	72
Mall .....	73
Kokën tund me një mendim një plep .....	75
Kam mall .....	77
Shi .....	79
Na bëjnë shoqëri trupat kozmike .....	81
Çështja Uotergej .....	83
Shoku Diego .....	87
Sateliti .....	89
Këngë për taksat .....	91

## POEMA

Isa Boletini .....	95
Shote Galica .....	104
Manush Alimani .....	116